

BULETINI I LAJMEVE TË SIGURISË KIBERNETIKE



Shtator 2023

Përmbajtja:

- Autoriteti Kombëtar për CESK, përfaqësuar nga Drejtori i Përgjithshëm Z. Igli Tafa, pjesëmarrës në Tallinn Digital Summit.
- Turneu virtual kibernetik
- Zëvendës Kryeministrja Znj. Belinda Balluku viziton Qendrën Operacionale të Sigurisë Kibernetike
- AKCESK pjesëmarrës në panairin "Future2Tech"



Autoriteti Kombëtar për CESK, përfaqësuar nga Drejtori i Përgjithshëm Z. Igli Tafa, pjesëmarrës në Tallinn Digital Summit.

Në panelin "Western Balkan Digital Security", kreu i AKCESK prezantoi sfidat e sigurisë kibernetike në nivel kombëtar pas sulmeve të sofistikuara të një viti më parë, duke theksuar bashkëpunimin ndërinstitucional dhe mbështetjen e partnerëve strategjikë ndërkombëtarë, për adresimin e tij.

Gjithashtu, në fjalën e tij Z. Tafa theksoi rëndësinë e ngritjes së kapaciteteve, fuqizimit të aspekteve të diplomacisë kibernetike, si dhe rritjen e ndërgjegjësimit, si prioritete kyçe për krijimin e një ekosistemi kibernetik të qëndrueshëm.

Samiti, i organizuar nga Qeveria Estoneze, nën kujdesin e Kryeministrit Kaja Kallas, mbledhi përfaqësues të rëndësishëm të fushës së sigurisë kibernetike, me qëllim forcimin e bashkëpunimit, adresimin e sfidave dhe identifikimin e mundësive të reja, për një të ardhme digjitale më të sigurt.



Zëvendës Kryeministrja Znj. Belinda Balluku viziton Qendrën Operacionale të Sigurisë Kibernetike

Zv.Kryeministrja Znj. Belinda Balluku vizitoi Qendrën Operacionale të Sigurisë Kibernetike, pranë AKCESK, ku monitorohen në kohë reale të gjitha kërcënimet kibernetike ndaj vendit tonë.

Shqipëria është shumë më e sigurtë se një vit më parë, falë përkushtimit dhe punës së të gjithë aktorëve qeveritarë dhe privatë, si dhe mbështetjes së vazhdueshme të partnerëve tanë strategjikë.



Turneu virtual kibernetik

Në datat 14-15 shtator 2023, SANS në bashkëpunim me AKCESK organizuan turneun virtual kibernetik, në formatin e aktivitetit "Capture the Flag", krijuar ekskluzivisht për komunitetin e sigurisë kibernetike të Evropës Qendrore dhe Lindore.

SANS Boot-up CTF ishte një konkurs argëtues ku pjesëmarrësit praktikuan aftësitë teknike të sigurisë kibernetike. Nëpërmjet aktiviteteve të ndryshme ata zbuluan pikat e tyre të forta dhe sfiduan kufijtë!



AKCESK pjesëmarrës në panairin "Future2Tech"

Në panairin e inovacionit Future2Tech, Drejtori i Përgjithshëm i AKCESK Z. Igli Tafa prezantoi progresin e Autoritetit, si një partner të besueshëm të infrastrukturave kritike të informacionit, mbi menaxhimin e rrezikut kibernetik dhe rritjen e sigurisë në nivel kombëtar ndaj sulmeve kibernetike të sofistikuara.

Partneriteti i brendshëm dhe i jashtëm përfaqëson një nga shtyllat e vizionit të sigurisë kibernetike të Autoritetit.

Siguria kibernetike është përgjegjësi e përbashkët. E ardhmja do të jetë edhe më e sigurt nëse bashkërendojmë përpjekjet tona dhe mendojmë globalisht, në terma të adresimit të sfidave të sigurisë në ekosistemin digjital.

BULETINI I LAJMEVE TË SIGURISË KIBERNETIKE



Shtator 2023

Përmbajtja:

- Gjigandi i teknologjisë Microsoft – partner strategjik i AKCESK
- AKCESK - Anëtar i 114 i Forumit Global të Ekspertizës Kibernetike (GFCE)
- Microsoft paralajmëron për një fushatë të re phishing
- Microsoft publikon patche për dy vulnerabilitete të reja të shfrytëzuara në mënyrë aktive



Gjigandi i teknologjisë Microsoft – partner strategjik i AKCESK

Autoriteti Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike dhe gjigandi i teknologjisë Microsoft, organizuan sot një takim të përbashkët me infrastrukturat kritike të informacionit, për rritjen e bashkëpunimit për një ekosistem digjital të sigurt në Shqipëri.

Partneriteti me këtë lider teknologjike, mbështetet në dy shtylla kryesore: implementimi i zgjidhjeve teknologjike të sigurta në treg dhe ngritja e kapaciteteve profesionale.


Microsoft, si një kompani lider në fushën e teknologjisë së informacionit dhe sigurisë kibernetike, ofroi hapësira bashkëpunimi për Autoritetin, duke treguar edhe një herë gadishmërinë e tij për të mbështetur Shqipërinë në rrugën e transformimit digjital dhe revolucionit kibernetik.



AKCESK - Anëtar i 114 i Forumit Global të Ekspertizës Kibernetike (GFCE)

Në kuadër të arritjes së objektivave strategjike, në terma të fuqizimit të kapaciteteve njerëzore në fushën e sigurisë kibernetike, Autoriteti Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike ka finalizuar me sukses procesin e anëtarësimit në Forumin Global të Ekspertizës Kibernetike.

AKCESK, në cilësinë e anëtarit të GFCE, do të kontribuojë në mënyrë efektive, në adresimin e nevojave kombëtare, në rritjen e bashkëpunimit dhe koordinimin efektiv ndërkombëtar për ndërtimin e kapaciteteve, me qëllim rritjen e nivelit të sigurisë kibernetike në nivel rajonal dhe global.




Microsoft publikon patche për dy vulnerabilitete të reja të shfrytëzuara në mënyrë aktive

Microsoft ka publikuar përditësime për 59 vulnerabilitete, duke përfshirë dy vulnerabilitete të tipit zero-day, të cilat janë shfrytëzuar në mënyrë aktive nga aktorë keqdashës kibernetikë.

Nga 59 vulnerabilitete, pesë janë vlerësuar si kritike.

AKCESK rekomandon përdoruesit e Microsoft që të kryejnë përditësimet sa më shpejt të jetë e mundur.

[Link: Lexo më shumë](#)



Microsoft paralajmëron për një fushatë të re phishing

Microsoft po paralajmëron për një fushatë të re phishing që përfshin përdorimin e mesazheve të Teams për të depërtuar në rrjetet e organizatave.

Ekipi i Inteligjencës së Kërcënimeve të gjigantit të teknologjisë është duke gjurmuar grupin e quajtur Storm-0324, i cili gjithashtu quhet TA543 dhe Sagrid.

[Link: Lexo më shumë](#)